



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1606/1 Prot

Tiranë, më 20.11.2019

V E N D I M

Nr.144, datë 20.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Korçë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Korçë,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e

shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Korçë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Korçë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhrin nr.14, datë 11.1.2019, të Kryetarit të Bashkisë, “*Për miratimin e strukturës të administratës të Bashkisë Korçë për vitin 2019*”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.152, datë 27.12.2018, “*Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2019 të Bashkisë Korçë*”.

Sipas kësaj strukture, Bashkia Korçë, së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **156** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **2** pozicione të kategorisë së lartë drejtuese, **13** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **27** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **114** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil të zëna (*104 pozicione*), janë plotësuar nga punonjës të emëruar rregullisht, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ndërsa **52** pozicione pune të shërbimit civil, rezultuan vende të lira.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit, është vepruar në përputhje me ligjin gjatë administrimit të shërbimit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Të përmbillet procesi i inspektimit të kryer në Bashkinë Korçë, pasi nuk janë evidentuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil nga ana e njësisë

përgjegjëse dhe e subjekteve të tjera të ngarkuara me detyra të veçanta për administrimin e shërbimit civil, në këtë institucion.

2. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Korçë, Prefektura e Qarkut Korçë, si dhe Ministria e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha